



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 568/Prot.
2

Tiranë, 10.02. 2020

VENDIM

Nr. 5, datë 10.02. 2020

***Për miratimin e rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe
Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës"***

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma *d* dhe nenin 131, pika 2 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenin 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës pas shqyrtimit të draft-rregullores të paraqitur nga grupi i punës i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik të UT-ës nr.1, datë 29.01.2020 "Për miratimin e grupit të punës për hartimin e Draft-Rregullores 'Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës'", në mbledhjen e tij të datës 10.02.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës".
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR. MYNIR KONI





**UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

RREGULLORE

**“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR
AUTORITETET DREJTUESE DHE SENATIN
AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

**Miratuar me Vendimin nr. 5. datë 10.02.2020 të Senatit Akademik
të Universitetit të Tiranës**

Tiranë, 2020



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregulla për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, vëzhgimin, fushatën elektorale, etikën elektorale dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës, duke përfshirë:

- a) kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre; për dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve dhe fushatat zgjedhore;
- b) rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
- c) kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;
- d) procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, si dhe për shpalljen e rezultateve;
- e) procedurat për shqyrtimin e ankimeve;
- f) administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zgjedhor;
- g) kushtet dhe afatet për regjistrimin e vëzhguesve, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës.

Gjithashtu kjo rregullore bazohet dhe në ligjet nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”* dhe nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*

Neni 3

Subjekti i rregullores

1. Subjekti i kësaj rregulloreje është Universiteti i Tiranës që do t'i referohet asaj në rast zhvillimi të proceseve zgjedhore për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njësive kryesore në Universitetin e Tiranës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur anëtari i personelit akademik i punësuar gjatë muajit të procesit zgjedhor.



3. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
4. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 63 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, shkëputen për një periudhë deri në 1 (një) vit për vitin sabatik nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në Senatin Akademik, por gëzojnë të drejtën të zgjedhin autoritetet drejtuese ose Senatin Akademik, nëse periudha e parashikuar më sipër përkon me periudhën zgjedhore.
5. Dispozita numër 4 e këtij neni nuk ka efekt për zgjedhjet përgjithshme të vitit 2020.
6. Çdo student aktiv i ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese (me përjashtim të drejtuesit të njësisë bazë) dhe të anëtarëve të Senatit Akademik. Çdo student aktiv ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.

Neni 4 **Parime të përgjithshme**

1. Zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës janë periodike, çdo 4 vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e 1 (një) vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej autoriteteve ose anëtarëve të Senatit Akademik.
4. Si mjet identifikimi për të votuar pranohet pasaporta, karta e identitetit ose karta e studentit.
5. Të drejtën për t’u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues (rektor dhe dekan/drejtor), e kanë edhe persona që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, të cilët i plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UT-së dhe nga kjo rregullore për të konkurruar për atë post.
6. Të drejtën për t’u zgjedhur si autoritet drejtues i Universitetit të Tiranës e ka çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë që nuk ka fituar në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion dy mandate të njëpasnjëshme ose të ndara, të fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të gjitha



mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes. Në kuptim të nenit 131 të ligjit 80/2015, mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar përmes një procesi zgjedhor, pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.

7. Çdo kandidat mund të konkurrojë njëkohësisht vetëm për 1 (një) post autoriteti drejtues.
8. Çdo kandidat ka të drejtë të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, sipas kalendarit të bashkërenduar me KIZ-in e KZF-në pranë çdo njësie kryesore/filial, pa cenuar procesin mësimor.
9. Shpallet i zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.
10. Kur kandidon një kandidat i vetëm ai shpallet fitues me jo më pak se 50 për qind plus një të votave të vlefshme. Nëse kandidati i vetëm nuk arrin të fitojë një numër të tillë votash, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Kur edhe pas raundit të dytë kandidati i vetëm nuk siguron 50 për qind plus një të votave të vlefshme, shpallen zgjedhje të reja.
11. Kur asnjëri prej dy a më shumë kandidatëve në garë për postin e një autoriteti drejtues nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të vlefshme, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë shumicën, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.
12. Në rast se për postin e një autoriteti drejtues nuk regjistrohet asnjë kandidat, si në rastin e kandidatit të vetëm, zgjedhjet për këtë post zhvillohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin për rektorin, si dhe me urdhër të rektorit për drejtuesin e njësisë kryesore dhe të njësive bazë, jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe me këtë rregullore. Gjatë periudhës kur nuk ka drejtues të zgjedhur, për caktimin e drejtuesit të njësive vepron sipas rregullit të përcaktuar në nenin 39, pika 9, pika 10, pika 11 dhe në nenin 42, pika 9 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*".
13. Zgjedhjet jashtë radhe zhvillohen jo më vonë se një vit përpara përfundimit të periudhës 4vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.
14. Në rastin kur për anëtarë të Senatit Akademik konkurrojnë më shumë kandidatë sesa numri i mandateve të caktuara për njësine kryesore përkatëse, fitues shpallen kandidatët që sigurojnë numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të Senatit Akademik



bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, në prani të palëve të interesuara, përveç rastit kur palët janë dakordësuar midis tyre.

15. Në rastin kur mbeten vende vakante për anëtarë në Senatin Akademik, për arsye se numri i kandidatëve është më i vogël sesa numri i mandateve, në njësinë kryesore përkatëse zhvillohet një raund i dytë zgjedhjesh, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Për këtë raund kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatë të tjerë që i plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.
16. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga personeli akademik duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë, në UT. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga studentët duhet të jenë studentë të njësisë kryesore përkatëse.

Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe Senatin akademik në Universitetin e Tiranës zhvillohen në mënyrë periodike, çdo katër vjet.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Autoriteti më i lartë drejtues në Universitetin e Tiranës shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga ministri për zgjedhjen e autoriteteve dhe senatin akademik në UT.
4. Zgjedhjet e radhës për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik të UT-së zhvillohen në njëjtën ditë.
5. Zgjedhjet jashtë radhe për autoritetet drejtuese thirren brenda 60 ditëve pas përfundimit para kohe të mandatit të autoritetit përkatës, nëse pjesa e mbetur e mandatit është jo më pak se një vit.
6. Qendrat e votimit hapen në orën 08:00 dhe mbyllen në orën 16:00. Askush nuk mund të votojë pasi KZF (KQV) merr vendim për mbylljen e procesit të votimit. Nëse pas orës 16:00 KZF (KQV) vëren se ka ende votues në radhë, u mbledh atyre mjetet e identifikimit dhe u mundëson votimin.



KREU II

INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Neni 6

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ)

1. Zgjedhja e anëtarëve të KIZ-it është detyrë dhe përgjegjësi e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës. Jo më vonë se tri ditë kalendarike pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve Senati Akademik zgjedh KIZ-in, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
 - a) Senati Akademik i zgjedh anëtarët e KIZ-it me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e të vetëkandiduarve që regjistrohen në sekretarinë e Senatit, e cila ka detyrimin t'i pajisë kandidatët me vërtetimin e regjistrimit. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KIZ-it përcaktohet mbi bazën e numrit të njërive kryesore të Universitetit të Tiranës. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 5, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga Senati Akademik caktohet dhe sekretari i KIZ-it, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve nga personeli i Universitetit të Tiranës.
 - b) Anëtarët e KIZ-it shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të UT-së.
 - c) Në rastin e largimit të një anëtari nga ky komision, zëvendësimi i tij kryhet si në pikën 1 të këtij neni.
 - d) KIZ-i konstituohet jo më vonë se katër ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
 - e) Anëtari i KIZ-it nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në Senatin Akademik.
 - f) Në mbledhjen e tij të parë KIZ-i zgjedh me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij kryetarin. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në të gjitha mjediset e institucionit dhe në faqen zyrtare elektronike të UT-së.
 - g) Gjatë periudhës zgjedhore KIZ-i mbledhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZ-it janë të hapura edhe për kandidatët e vëzhguesit e tyre.
 - h) KIZ-i i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KIZ-it publikohen në këndet zgjedhore të Universitetit të Tiranës, si dhe në faqen zyrtare elektronike të Universitetit dhe fakulteteve, jo më vonë se 12 orë pas vendimmarrjes.
2. KIZ-i ka këto kompetenca:
 - a) Nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e Universitetit të Tiranës.
 - b) Drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor.
 - c) Emëron anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve, të vetëkandiduar në KIZ.



- d) Akrediton vëzhguesit sipas kërkesave të palëve të parashikuara në këtë rregullore.
 - e) Vendos për numrin e qendrave të votimit për çdo njësi kryesore.
 - f) Miraton vulën për KIZ-in, KZF-në dhe KQV-në, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi. Vulat do të administrohen nga sekretaria e KIZ-it dhe KZF-së.
 - g) Regjistron kandidatët për rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik.
 - h) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik.
 - i) Administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
3. Mandati i anëtarit të KIZ-it ndërpritet në rastet kur:
- a) cënon etikën zgjedhore;
 - b) vdes;
 - c) jep dorëheqjen nga detyra;
 - d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e KIZ-it dhe procesin zgjedhor;
 - f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Trajtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtarit të KIZ-it në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij. KIZ-i merr vendim mbi këtë kërkesë, jo më vonë se 1 orë pas depozitimit të saj. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ-i kur për të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda tri ditëve prej Senatit Akademik.
4. Sekretari i KIZ-it përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ-it. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve në librin e procesverbaleve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjes duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZ-it është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ-it. Libri i procesverbaleve dhe vula e KIZ-it ruhen në ambientin e përcaktuar nga administratori për KIZ-in.
5. Vendimet e KIZ-it firmosen prej të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe vulosen me vulën e KIZ-it. Çdo anëtar i KIZ-it krahas nënshkrimit të tij mund të deklarojë në vendim votën kundër.
6. Kandidatët për rektor kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre pranë KIZ-it, si anëtar *ex-officio*, pa të drejtë vote, gjatë muajit zgjedhor.

Neni 7

Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, merret nga KIZ-i, jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga dita e formimit të tij. KIZ-i zgjedh anëtarët e KZF-së me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që vetëkandidohen në sekretarinë e KIZ-it, e cila ka detyrimin t'i pajisë kandidatët me vërtetimin e regjistrimit.



2. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KZF-së përcaktohet mbi bazën e numrit të njësive bazë në njësinë kryesore përkatëse. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga KIZ-i caktohet dhe sekretari i KZF-së, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve nga personeli i njësisë kryesore të KZF-së përkatëse.
3. Anëtari i KZF-së nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të cilitdo niveli.
4. Mbledhja e parë e KZF-së zhvillohet një ditë pas vendimit të KIZ-it për ngritjen e tij. Në këtë mbledhje zgjidhet, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KZF-së, kryetari. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në mjediset ku zhvillon aktivitetin akademik njësia kryesore përkatëse, si dhe në faqen zyrtare elektronike të fakultetit.
5. KZF-ja mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në mbledhjet e KZF-së mund të jenë të pranishëm kandidatët ose vëzhguesit.
6. KZF-ja i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KZF-së publikohen në mjedisin e njësisë kryesore ku është vendosur zyra e tij (i përcaktuar nga administratori i njësisë kryesore), si dhe në faqen zyrtare elektronike të Fakultetit, jo më vonë se 12 orë pas marrjes se tyre.
7. KZF-ja ka këto kompetenca:
 - a) Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë kryesore.
 - b) Kryen funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit për anëtarët e personelit akademik.
 - c) Emëron kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, kur, me vendim të KIZ-it, në njësinë kryesore votimi do të zhvillohet në më shumë se një qendër votimi.
 - d) Regjistron kandidatët për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësive bazë.
 - e) Publikon listën e zgjedhësve në mjediset e njësisë kryesore/filiali, si dhe në faqen zyrtare elektronike të fakultetit, pas miratimit përfundimtar të saj.
 - f) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësive bazë dhe ia dërgon KIZ-it.
 - g) Nxjerr rezultatin e votimit për rektorin dhe për anëtarët e Senatit Akademik, të cilat i dërgon në KIZ.
 - h) Merr vendim brenda kompetencave të veta mbi ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
8. Kandidatët për dekan dhe drejtues të njësive bazë kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në KZF dhe KQV, si vëzhgues, të cilët akreditohen prej KIZ-it. Vëzhguesit duhet të jenë pjesë me kohë të plotë e personelit akademik.
9. Mandati i anëtarit të KZF-së ndërpritet në rastet kur:



- a) cënon etikën zgjedhore;
- b) vdes;
- c) jep dorëheqjen nga detyra;
- d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e KZF-së dhe procesin zgjedhor;
- f) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Shqyrtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtarit të KZF-së në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij, të cilët e paraqesin atë te KIZ-i. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ-i, jo më vonë se 1 orë pas paraqitjes së kërkesës. Për të duhet të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi bosh plotësohet brenda 2 ditëve prej KIZ-it.

10. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve në librin e procesverbalit dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZF-së. Sekretari përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve pjesë e personelit të njësisë kryesore. Vendimet e KZF-së firmosen prej të gjithë anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe vulosen me vulën KZF-së.

Neni 8 Qendrat e Votimit

Pranë çdo njësie kryesore caktohen Qendrat e Votimit nga KIZ-i. Si rregull, çdo qendër votimi ka deri në 1000 (një mijë) zgjedhës, të të gjitha trupave zgjedhore, përfshirë studentët. Në rast se njësia kryesore ka më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës, KIZ-i mund të caktojë më shumë se një qendër votimi për atë njësi kryesore.

Neni 9 Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

1. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore, detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së. Kur KIZ-i ka vendosur ngritjen e më shumë se një qendre votimi në njësinë kryesore, KZF-ja ngre komisionet e qendrave të votimit (KQV).
2. KQV-ja përbëhet nga 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e KQV-së emërohen prej KZF-së në bazë të vetëkandidimeve.
3. Vendimi për formimin e KQV-së merret prej KZF-së jo më vonë se tri ditë para ditës së votimit. Në këtë vendim caktohet edhe kryetari i KQV-së. Njëri prej anëtarëve kryen detyrat e sekretarit të KQV-së.



4. Anëtari i KQV-së nuk mund të kandidojë për asnjë post drejtues ose anëtar në Senatin Akademik.
5. Komisioni i Qendrës së Votimit ka për detyrë vetëm organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit ditën e zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi, KQV-ja administron materialet zgjedhore, sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në këtë rregullore dhe ia dorëzon ato KZF-së.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

Çdo kandidat/e i/e vetëkandiduar për autoritet drejtues dhe Senatin Akademik të UT ka të drejtë të caktojë 1 vëzhgues në KZF, KQV dhe për çdo tavolinë në vendin e numërimit të votave pas regjistrimit të kandidatit/es në procesin zgjedhor.

Organizata joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhjet e UT-së. Akreditimi i tyre ka të njëjtën procedurë si dhe ai vëzhguesve të kandidatëve konkurrentë, anëtarë të stafeve akademike apo studentëve në UT. Ai bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi.

Në rastin e organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, ato janë të detyruara të hartojnë një raport vlerësimi për procesin zgjedhor, 15 ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Vëzhguesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e tyre si vëzhgues, i ndalohet rreptësisht prishja e qetësisë, filmimi dhe bërja e fotografive gjatë procesit të votimit dhe numërimit. Në rast të shkeljes së këtyre standardeve etike, i tërhiqet vëmendja publikisht. Në rast përsëritjeje KIZ/KZF merr vendim për përjashtimin e tij/saj me shumicë votash.

1. Gjatë kryerjes së detyrës së tyre vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
 - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
 - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
 - a) të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe udhëzimet e KIZ-it për vëzhgimin e zgjedhjeve;
 - b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas kësaj rregulloreje;



- c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KIZ-i, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KIZ-i;
- d) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve;
- e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesve për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë aktivitetin e KZF-së/ KQV-së në procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

KREU III

ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE

Neni 11

Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve

1. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës marrin pjesë:

Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njësive kryesore në Universitetin e Tiranës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur anëtari i personelit akademik i punësuar gjatë muajit zgjedhor.

Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kanë mbushur *moshën për pension*, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.

Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 63 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, shkëputen për një periudhë deri në 1 (një) vit për vitin sabatik nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në Senatin Akademik, por gëzojnë të drejtën të zgjedhin autoritetet drejtuese ose Senatin Akademik, nëse periudha e parashikuar më sipër përkon me periudhën zgjedhore. Ky parashikim nuk ka efekt për zgjedhjet përgjithshme të vitit 2020.

Çdo student aktiv i ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese (me përjashtim të drejtuesit të njësisë bazë) dhe të anëtarëve të Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve në të. Çdo student aktiv ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.



studentët afishohet në mjediset e njësisë kryesore, filialit 15 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Një kopje e kësaj liste i dërgohet KIZ-it 15 ditë para datës së zgjedhjeve.

- f) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore, filialit dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
7. Pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së zgjedhjeve, lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët nuk mund të korrigjohet për asnjë arsye. Pas kësaj periudhe zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë, mund të votojnë vetëm në rastin kur, pas shqyrtimit të kërkesës së tyre KIZ-i shprehet me vendim lidhur me kërkesat për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa të tilla KIZ-i mund t'i shqyrtojë deri në 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Zgjedhësi i pajisur me vendimin e KIZ-it mund të votojë vetëm duke u paraqitur në Komisionin e Qendrës së Votimit.
8. E gjithë procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët mbikëqyret prej KIZ-it. Për këtë qëllim KIZ-i miraton një plan pune kalendar dhe cakton dy prej anëtarëve të tij për ndjekjen e këtij procesi. Anëtarët përgjegjës raportojnë periodikisht në KIZ për ecurinë e procedurave për hartimin e listës së zgjedhësve.

Neni 12

Trupa zgjedhore për anëtarët e personelit akademik të Senatit Akademik

Trupa zgjedhore për Senatin Akademik të UT-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik të UT-së përbëhet nga studentët aktiv që ndjekin studimet me kohë të plotë në ciklin e parë dhe të dytë, siç është përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Trupa zgjedhore për rektorin

Trupa zgjedhore për rektorin e UT-së përbëhet nga:

- a) personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore dhe filialeve. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
- b) studentët të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje. Votat e studentëve në zgjedhjen e rektorit llogariten në masën 10 % (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.



2. Lista e zgjedhësve për personelin akademik hartohet për çdo njësi bazë sipas të dhënave të regjistrit të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë, që administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore të çdo njësie kryesore të Universitetit të Tiranës. Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë: a) emri
b) atësia
c) mbiemri
d) datëlindja
e) gjinia
f) njësia bazë ku është i punësuar/programi mësimor që ndjek studenti.
3. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve janë zyrat e burimeve njerëzore të njësive kryesore të UT-së, ndërsa për studentët sekretaritë mësimore përkatëse.
4. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:
 - a) Lista paraprake e zgjedhësve për personelin akademik të njësisë bazë hartohet nga zyrat e burimeve njerëzore të njësive kryesore, filialeve 30 ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.
 - b) Lista paraprake dërgohet në njësinë bazë përkatëse, e cila brenda 24 orëve verifikon dhe miraton përbërjen e saj. Lista e miratuar nga përgjegjësi/ i ngarkuari me detyrën e përgjegjësit, të njësisë bazë i dërgohet dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore, filialit, i cili e miraton dhe e shpall brenda dy ditëve, Lista e miratuar afishohet në mjediset e njësisë kryesore, filialit (në këndin zgjedhor dhe faqen zyrtare elektronike të internetit). Një kopje e listës i dërgohet KIZit.
 - c) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore, filialit dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
5. Lista përfundimtare miratohet nga dekani/drejtori i njësisë kryesore, filialit. Në këtë listë nuk mund të shtohet asnjë anëtar i personelit akademik i punësuar pas shpalljes së listave paraprake. Kjo listë shpallet 15 ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.
6. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është sekretaria mësimore e njësisë kryesore. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është si më poshtë:
 - a) Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej sekretarisë mësimore të njësisë kryesore 30 ditë nga shpallja e datës së zgjedhjeve.
 - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore (kënd zgjedhor dhe faqen zyrtare elektronike të internetit).
 - c) Gjatë një periudhe deri në 10 ditë pas shpalljes së listës paraprake sekretaria mësimore pranon kërkesat për korrigjime.
 - d) Pas verifikimit të kërkesave sekretaria bën korrigjimet e kërkuara brenda 5 ditëve.
 - e) Pas përfundimit të periudhës për korrigjimin e listës, sekretaria harton listën përfundimtare e cila miratohet prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore ose filialit. Lista përfundimtare e zgjedhësve për



Neni 15

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore/filial të UT-së përbëhet nga:

- a) personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
- b) studentët, të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, në atë njësi kryesore. Votat e studentëve në zgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore llogariten në masën 10 % (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 16

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë të UT-së

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë të UT-së përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë. Personel akademik me kohë të plotë do të konsiderohet personeli i përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

KREU IV

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 17

Regjistrimi i kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për autoritetet drejtuese dhe Senatin akademik në UT fillon ditën e shpalljes nga komisioni zgjedhor përkatës dhe përfundon në orën 16:00 të ditës së pestë kalendarike.
2. Dita për fillimin e regjistrimit të kandidatëve për rektor dhe për anëtar të Senatit Akademik të UT-së shpallet prej KIZ-it, 2 (dy) ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
3. Dita për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve për dekan/drejtore të njësisë kryesore, përgjegjës të njësisë bazë, departament/qendër kërkimi të njësive kryesore, shpallet prej KZF-së dy ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
4. Mosregjistrimi i kandidatëve bëhet me vendim të arsyetuar nga KIZ-i. Vendimi për mosregjistrimin e kandidatëve është i ankimueshëm pranë Komisionit të Apelit në UT.
5. Kandidatët e regjistruar pranë KIZ/KZF për autoritet drejtues në UT dhe Senat Akademik nuk mund të heqin dorë nga kandidimi gjatë procesit zgjedhor.



Neni 18

Kriteret për anëtarët e Senatit Akademik

1. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, nenin 30 të Statutit të UT-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.
3. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik në UT, përfaqësues të studentëve, i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Kandidatët duhet të kenë mesataren mbi 8 (tetë) të provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit. Në rastet kur një student i zgjedhur në Senatin Akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara, në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur. Nëse nuk ka studentë të mbetur në listë, zhvillohen përsëri zgjedhjet, siç parashikohet në këtë rregullore.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Senatit Akademik anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë ose studentët që:
 - a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”* dhe ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*;
 - e) nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
 - për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015.

Neni 19

Kriteret për rektor të UT-së

1. Kandidatët për rektor të UT-së duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 33 të Statutit të UT-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për rektor të UT-së duhet të mbajnë titullin “Profesor” dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë të UT-së ose jashtë tij. Kandidatët për rektor vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:



- a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.
3. Nuk mund të kandidojnë për rektor të UT-së personat që:
- a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”* dhe ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*;
 - e) nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it)
 - për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015;
 - f) kanë qenë rektorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, *“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
 - g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015.
 - h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 20

Kriteret për drejtues të njësisë kryesore në UT

1. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UT duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 46 të Statutit të UT-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UT i përkasin kategorisë “Profesor” dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë të UT-së ose jashtë tij. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në UT personat që:



- a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
- b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
- d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- e) nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it)
 - o për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - o garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ligji nr. 138/2015;
- f) kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;
- g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015;
- h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 21

Kriteret për drejtues të njësisë bazë në UT

1. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UT duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 50 të Statutit të UT-së dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UT janë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë që i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë duhet:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet dhe të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b) të kenë veprimtari të spikatur akademike, kërkimore dhe shkencore të vazhdueshme.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë bazë në UT kandidatët që:
 - a) janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b) janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) janë të dënuar më parë për vepra penale;
 - d) kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”



dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

e) nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it)

- për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
- garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ligji nr. 138/2015;

- f) kanë qenë drejtues të njësisë bazë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara, në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;
- g) kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015;
- h) kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 22

Kandidimi

1. Kandidatët për autoritete drejtuese të të gjitha niveleve dhe për Senatin Akademik vetëkandidohen.
2. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, të cilët plotësojnë kriteret e nenit 19, pika 3, të kësaj rregulloreje, propozohen nga jo më pak se 100 studentë, pjesë e trupës zgjedhore, të cilët mbështesin vetëm një kandidat. Në fletën që dëshmon për mbështetjen nga 100 studentë, duhet të jenë pasqyruar emri, mbiemri, mjeti i identifikimit si dhe fakulteti/dega nga vjen studenti.
3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UT-së dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ e KZF dhe përmban:
 - a) kërkesën për kandidim, e cila përmban:
 - emrin;
 - atësinë;
 - mbiemrin;
 - datëlindjen;
 - gjininë;
 - b) kopje të dokumentit të identifikimit;



- c) kopje të titullit akademik (të noterizuar vetëm për kandidatët që vijnë nga jashtë UT-së);
- d) dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar dhe vitet e punësimit.
- e) shprehjen e vullnetit për kandidim;
- f) formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për: o deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "*Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- g) mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
- h) deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- i) deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" dhe ligjit nr. 45/2015 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*";
- j) deklarimin për neutralitetin politik dhe angazhimin që të mos zhvillojë në institucion veprimtari në dobi të forcave politike.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- o të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet
- o të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

2. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:

- a) kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në një nga njësitë kryesore të UT-së;
- d) propozimin nga jo më pak se 100 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në këtë rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit;
- e) dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

3. Pas verifikimit të dokumentacionit KIZ-i, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për rektor dhe të kandidatëve për Senatin Akademik. Listat shpallen publikisht në mjediset e institucionit (këndi zgjedhor) dhe në faqet zyrtare elektronike të të gjitha njësive kryesore të UT-së.

4. Pas verifikimit të dokumentacionit KZF, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për drejtues, dekan/drejtor,



të njësisë kryesore, si dhe listën e kandidatëve për drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor, për secilën prej njësive baze/qendrave të kërkimit shkencor të njësisë kryesore, si dhe listën e kandidatëve për anëtar të Senatit Akademik.

5. Pas regjistrimit çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij. Forma e këtij vërtetimi miratohet me vendim të KIZ-it.

Neni 24

Kohëzgjatja e mandateve

1. Autoritetet drejtuese dhe anëtarët e Senatit Akademik të UT-së zgjidhen për një mandat 4-vjeçar. Rastet e ndërprerjes së mandateve përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi.
2. Mandati i anëtarëve të KIZ-it/KZF-së dhe Komisionit të Apelit është 4-vjeçar.

Neni 25

Përfaqësimi i njësive kryesore në Senatit Akademik

Bazuar në nenet 33 e 37 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 32 të statutit të UT-së, Senati Akademik i UT-së përbëhet nga 35 anëtarë, 4 përfaqësues për çdo fakultet, 4 përfaqësues të studentëve, dekanët e fakulteteve dhe rektori.

Neni 26

Fushata zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon në datën e përcaktuar nga urdhri i autoritetit përkatës (ministri, rektori).
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Administratorët dhe administrata e UT-së duhet t’u krijojë kushte të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit, bashkërenduar edhe me kalendarin e miratuar nga KIZ/KZF për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, jashtë orëve të mësimi që zhvillohen në institucion.



KREU V

PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR

Neni 27

Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe e vendeve të numërimit të votave

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Zyra e KIZ-it vendoset në godinën ku ndodhet administrata qendrore e UT-së.
 - b) Zyra e KZF-së vendoset në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore/filiali.
 - c) Zyrat e KIZ/KZF pajisen nga administratori përkatës ku zhvillohet aktiviteti me logjistikën e nevojshme për aktivitetin e tyre.
2. Vendet e numërimit të votave përcaktohen sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Votat për rektorin, drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor dhe për anëtar të Senatit Akademik, numërohen në një ambient në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
 - b) Ambienti i numërimit të votave duhet të ketë përmasa të atilla që të krijojnë mundësi për procesin e numërimit të votave. Organizimi i ambientit për numërimin votave duhet t'u japë mundësi kandidatëve dhe vëzhguesve të tyre për të qenë të pranishëm, gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Neni 28

Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat për rektor, anëtar të Senatit Akademik, drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor, vlerësohen dhe numërohen prej KZF-së.
2. KZF-ja, pas numërimit të votave, sipas radhës së përcaktuar në nenin 35 plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ-it, brenda 24 orëve nga ora e mbylljes së procesit të votimit.
3. KIZ-i, pas plotësimit të afateve për ankimimin, shpall fituesit, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 29

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të UT-së personeli akademik voton me katër fletë të dallueshme nga njëra-tjetra:
 - a) fletëvotimi për rektor;
 - b) fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) fletëvotimi për drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor;
 - d) fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik.



2. Në zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik studentët votojnë me tri fletëvotimi të dallueshme nga njëra-tjetra:
 - a) fletëvotimi për rektor;
 - b) fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
 - c) fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
3. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listës përfundimtare, duke i shtuar 2 % (dy për qind).
4. Standardet e fletës së votimit hartohen dhe miratohen nga KIZ-i. Duhet të jetë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë me numër serial unik. Informacioni që përmban fleta e votimit është:
 - a) në krye të fletës së votimit vendoset emërtesa për të cilën do të përdoret;
 - b) emërtimi i autoritetit drejtues ose Senati Akademik;
 - c) emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetin drejtues ose Senatin Akademik përkatës pasqyrojnë të dhënat e kandidatit në mjetin e identifikimit zyrtar. Kandidatët renditen sipas rendit alfabetik;
 - d) në fletën e votimit për autoritetet drejtuese dhe anëtar për Senatin Akademik, zgjedhësi vendos në krah të emrit të kandidatit vetëm këto tri shenja “x” “+” “√”. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri.
 - e) në rastin kur për autoritetin drejtues ose anëtar të Senatit Akademik është regjistruar dhe konkurron vetëm një kandidat, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alterantivat për votim “Pro” ose “Kundër”;
 - f) fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar “Për student”.

Neni 30

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZ në KZF

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve KIZ-i dërgon në KZF materialet zgjedhore, si më poshtë:
 - a) fletët e votimit për personelin akademik dhe për studentët, sipas nenit 29, pika 3, të kësaj rregulloreje.
 - b) listën përfundimtare të zgjedhësve për personelin akademik dhe listën e zgjedhësve për studentët, të vulosura nga KIZ-i;
 - c) vulën e KZF-së;
 - d) vulat e KQV-ve, në rast se në njësinë kryesore do të ketë më shumë se një qendër votimi.
 - e) procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë: procesverbalet për kodet e sigurisë së kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - f) zarfin në të cilin është shënuar “Fletë votimi të dëmtuara”;
 - g) zarfin në të cilin është shënuar “Fletë votimi të papërdorura”;
 - h) zarfin në të cilin është shënuar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”;
 - i) zarfin në të cilin është shënuar “Zarfi i fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar”.
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore, në KZF dërgohen edhe kutitë e votimit:
 - a) kutia e votimit për rektor;
 - b) kutia e votimit për dekan/drejtor të njësisë kryesore;



- c) kutia e votimit për përgjegjës të njësisë bazë/qendër e kërkimit shkencor;
- d) kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik i njësisë kryesore;
- e) kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
- f) libri i protokollit të mbledhjeve të KZF-së;
- g) tabelat për rezultatin e zgjedhjeve për secilën kategori;
- h) dhomat e fshehta;
- i) vulat me kodet e sigurisë.

KREU VI

VOTIMI

Neni 31

Veprimet paraprake për hapjen e Qendrës së Votimit

1. KZF nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në praninë e vëzhguesve, një orë përpara hapjes së Qendrës së Votimit, kryen këto detyra:
 - a) vendos tryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, por edhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
 - b) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm, brenda Qendrës së Votimit;
 - c) afishon tabelat që ndalojnë përdorimin e çdo objekti që cënon fshehtësinë e votës;
 - d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - e) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta – në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emërtimi për autoritetin që do të votohet, me ngjyrë të njëjtë me atë të fletës përkatëse të votimit;
 - f) mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”, i cili futet në kutinë e votimit për rektor, para fillimit të procesit të votimit;
 - g) sigurohet që në ambientet zgjedhore të mos ketë persona dhe shenja që cënojnë parimin e paanshmërisë dhe drejtësisë në procesin zgjedhor.
2. Anëtarët e KZF-së, në prani të kandidatëve e vëzhguesve të akredituar nga KIZ-i, në rast se paraqiten, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.
3. Të njëjtat veprime kryhen edhe nga KQV-ja në rastet kur në njësinë kryesore votimi kryhet në më shumë se një qendër votimi.



Neni 32
Procedurat e votimit

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatin Akademik në UT zhvillohen në të njëjtën ditë, në datën e caktuar nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për proceset zgjedhore të radhës.
2. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZF-së/KQV-së deklaron hapjen e votimit, jo më përpara se ora 08:00.
3. Sekretari shënon në librin e protokollit të KZF-së/KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të komisionit prej qendrës së votimit.
4. Fletët e votimit vulosen në pjesën e pasme, majtas lart, me vulën e KZF-së, e cila mban respektivisht shkrimin "KZF" dhe emrin e njësisë kryesore/njesisë bazë.
5. Në Qendrën e Votimit vendosen kuti votimi në numër të barabartë me numrin e autoriteteve drejtuese, rektor, dekan/drejtor, përgjegjës departamenti/qendre shkencore për të cilat kryhet votimi në njësinë kryesore të UT-së dhe dy kuti për Senatin Akademik, një për anëtarët e Senatit nga personeli akademik dhe një për anëtarët e Senatit përfaqësues të studentëve.
6. Në mjediset e njësive kryesore, ku kryhet procesi i votimit ndalohet rreptësisht çdo lloj forme fushate zgjedhore për kandidatët konkurrentë.
7. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë Qendrës së Votimit dhe futen njëri pas tjetrit në Qendrën e Votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi hyn në Qendrën e Votimit:
 - a) zgjedhësi paraqet para Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV) një nga dokumentet zyrtare të vlefshme për identifikimin e tij:
 - o pasaportë,
 - o kartë identiteti,
 - o kartë studenti
 - b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identifikimit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën përfundimtare të zgjedhësve, të vulosur nga KIZ-i, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin personal të dokumentit të identifikimit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - c) zgjedhësi që është pajisur nga KIZ-i me vendim për të votuar, pasi hyn në qendër e paraqet atë te kryetari i qendrës. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri personal i mjetit të tij të identifikimit shënohet në një regjistër të veçantë;
 - d) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - e) zgjedhësit, personel i stafit akademik, i jepen për të votuar fleta e votimit për rektor, fleta e votimit për anëtar të personelit akademik në Senatin Akademik, fleta për drejtues të njësisë kryesore dhe fleta për përgjegjës departamenti/qendre kërkimore shkencore në të cilën bën pjesë;



- f) zgjedhësit student i jepet për të votuar fleta e votimit për rektor, fleta për drejtues të njësisë kryesore dhe fleta për anëtar në Senatin Akademik, përfaqësues i studentëve;
- g) çdo fletë votimi vulloset, majtas lart, me vulën e KZF-së/ KQV-së;
- h) pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:
 - o në fletën e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë shënon në krah të emrit të kandidatit vetëm një nga këto tri shenja “x”, “+”, “√”. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkurron vetëm një kandidat, zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruara krahas emrit të kandidatit “Pro” ose “Kundër”;
 - o në fletën e votimit për anëtar të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve vetëm një nga këto tri shenja “x”, “+”, “√”. Zgjedhësi duhet të shënojë jo më shumë emra sesa është numri i mandateve në Senatin Akademik që i përket njësisë kryesore përkatëse;
 - o pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga Qendra e Votimit.
- i) Nëse shënimin në fletën e votimit ose, së paku, në një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E dëmtuar” dhe e fut atë në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara”. Në këtë rast zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër, e të njëjtit lloj, dhe rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletëvotimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet “e dëmtuar” dhe futet në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” dhe zgjedhësit i jepet një fletëvotimi e dytë. Rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose e dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara dhe të pavlefshme nuk hidhen në kutitë e votimit.
- j) Qendra e Votimit organizohet në një mënyrë të tillë që ta lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit ose regjistrimit nga ana e votuesit. Në Qendrën e Votimit mund të qëndrojnë vetëm: o anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së; o zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre; o vëzhguesit e akredituar.

Neni 33 Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.



2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit.
Pas kësaj, në Qendrën e Votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së, kandidatët, si dhe vëzhguesit e akredituar nga KIZ-i.

Neni 34

Veprimet pas mbylljes së Qendrës së Votimit

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KZF/KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve
 - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar nga personeli i stafit akademik dhe studentët, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, si dhe të atyre që janë në regjistrin e veçantë, e që kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.
 - b) ua deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit dhe vëzhguesve të pranishëm;
 - c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij;
 - d) urdhëron sekretarin e komisionit të shënojë në procesverbalin për “Mbylljen e votimit” numrin e personave që kanë votuar në Qendrën e Votimit. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve, pasqyron në procesverbalin për “Mbylljen e votimit” numrin e plotë të fletëve të votimit të Qendrës së Votimit, për secilën prej kategorive, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KIZ-i, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara për secilën kategori.
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura për secilën prej kategorive dhe, në përfundim të numërimit, ua bën të ditura shifrat anëtarëve të komisionit. Nëse kërkohet nga një anëtar i komisionit ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit fletët e votimit të papërdorura mbyllën në zarfin ku është shënuar “Fletë votimi të papërdorura” për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për “Mbylljen e votimit”.
5. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara” për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për “Mbylljen e votimit”.
6. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, futen:
 - a) në kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e rektorit:
 - zarfi “Fletë votimi të papërdorura për zgjedhjen e rektorit”;
 - zarfi “Fletë votimi të dëmtuara për zgjedhjen e rektorit”;



- procesverbal për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara.
 - b) Për secilën kategori veprohet në të njëjtën mënyrë.
7. Mbyllet kutia e votimit. Elementet e sigurisë për mbylljen e këtyre kutive shënohen në procesverbal.
 8. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore përkatëse dërgohet në KIZ, brenda 24 orëve nga mbyllja e procesit të votimit. Kutitë shoqërohen nga dy anëtarë të KZF-së dhe mund të shoqërohen nga vëzhguesit e kandidatëve.
 9. Në rastin kur në njësinë kryesore votimi është kryer në më shumë se një qendër votimi, Komisioni i Qendrës së Votimit pas administrimit të materialeve zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, i dorëzon ato së bashku me kutinë e votimit për rektor në KZF, i cili është përgjegjës për transportin e tyre në KIZ.

Neni 35

Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, për anëtar në Senatin Akademik, autoritetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njësitë bazë

1. Procedurat për vlerësimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, autoritetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njësitë bazë, për anëtar në Senatin Akademik kryhen prej KZF-së, në vendin e numërimit të votave, që ndodhet në mjediset e njësisë kryesore.
2. Në rastin kur procesi i votimit është kryer në më shumë se një qendër votimi në njësinë kryesore, Komisioni i Qendrës së Votimit, pasi ka përfunduar administrimin e materialeve zgjedhore, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, ia dorëzon ato në vendin e numërimit të votave, KZF-së. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit bëhet me procesverbal.
3. Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:
 - a) rektor;
 - b) drejtues i njësisë kryesore;
 - c) drejtues i njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor;
 - d) anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë).
4. Kryetari hap kutinë e votave për rektor, nxjerr nga kutia fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj:
 - a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ua treguar të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
 - b) numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;



- c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të ishin në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të KZF/KQV-së për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletët e votimit të papërdorura dhe fletët e votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;
 - d) ndan në grupe të veçanta votat e hedhura nga personeli akademik dhe nga studentët dhe numëron votat e secilit grup. Numri i tyre shënohet në procesverbal;
 - e) ndan votat e personelit akademik në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal;
 - f) ndan votat e studentëve në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal;
 - g) harton tabelën përfundimtare për votimin në njësinë kryesore përkatëse dhe e miraton me vendim.
5. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ-i;
 - b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;
 - c) në fletën e votimit janë bërë shënime ose shenja të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore;
 - d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
 - e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit për autoritetet drejtuese;
 - f) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët në fletën e votimit;
 - g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person ose subjekt që nuk është në fletën e votimit.
 6. Në rast se në njësinë kryesore është votuar në më shumë se një qendër votimi, KZF-ja vlerëson dhe numëron votat për secilën qendër votimi, sipas procedurës së përshkruar më sipër.
 7. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave për rektor, KZF-ja harton tabelën e rezultatit të votave për rektor. Kopje e tabelës së rezultatit të votave për rektor u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve dhe vëzhguesve.
 8. Në rastin kur nuk ka asnjë fitues, KIZ-i, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, merr vendim për organizimin dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.
 9. KZF-ja vazhdon procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, për anëtarët e Senatit Akademik.
 10. Anëtarët e KZF-së, në rast mosdakordësie, gjatë numërimit të votave, referuar rasteve të fletëvotimeve të diskutueshme, marrin vendimin mbi to me shumicë të thjeshtë votash. Kjo zgjidhje e përjashton kategorikisht bllokimin e procesit zgjedhor.



11. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZF-ja harton tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë rezultatet për secilën kategori. Tabela përfundimtare dhe vendimi i KZF-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët duke deklaruar votën "Pro" ose "Kundër" dhe vulosen nga sekretari. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve të kandidatëve.

12. Mënyra e përllogaritjes së votave për autoritetet drejtuese për të cilat votojnë dhe studentë bëhet sipas kësaj mënyre:

Shpallja e kandidatit fitues duke u bazuar në rezultatin si votë e plotë.

$N \rightarrow$ Numri i votave të vlefshme nga personeli akademik.

$X \rightarrow$ Numri total i votave (personel akademik + student)

$N = 90\%$

$X = 100\%$

$X = (N \times 100)/90$

$Y \rightarrow$ Vota e studentëve

$Y = X - N$

Një votë pedagogu (Z) = S/Y

$S \rightarrow$ Votat totale të vlefshme, të numëruara nga studentët.

Kandidati A: Votat e konvertuara të studentëve në votë të plotë ($A1$):

Votat nga studentët për këtë kandidat/ Z

Kandidati B: Votat e konvertuara nga studentët në votë të plotë ($B1$): Votat nga studentët për këtë kandidat/ Z

Votat totale të plota, të fituara nga Kandidati A = $N_A + A1$ Votat totale të plota, të fituara nga Kandidati B = $N_B + B1$

N_A dhe N_B janë respektivisht votat e fituara nga secili kandidat i personelit akademik.

$N_A + N_B = N$

13. Vendimet e KZF-së për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen në KIZ.

14. Gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave në vendin e numërimit të votave kanë të drejtë të qëndrojnë anëtarët dhe sekretari i KZF-së, kandidatët dhe vëzhguesit e tyre të akredituar nga KIZ-i.

15. Çdo kontestim i kandidatëve ose i vëzhguesve të tyre, shënohet detyrimisht në librin e procesverbaleve nga sekretari i KZF-së.



Neni 36

Ankimet

1. Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për autoritetet drejtuese ose anëtar në Senatin Akademik të UT-së ka të drejtë të ankohet në KIZ kundër vendimeve të KZF-së që çenojnë interesat e tij, brenda dy ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër vendimeve të KZF-së për shpalljen e tabelave të rezultatit, tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe rezultatit të zgjedhjeve, ankimi bëhet në KIZ, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre.
3. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha dyditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16:00, pas dy ditëve kalendarike.
4. KIZ-i administron dhe merr vendim për ankimet për çështje që nuk lidhen me rezultatin e zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së tyre.
5. KIZ-i administron dhe merr vendime për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve, jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.
6. Çdo vendim i KIZ-it është i ankimueshëm në Komisionin e Apelimit, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit. Komisioni i Apelimit shprehet me vendim të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

Neni 37

Komisioni i Apelimit

1. Komisioni i Apelimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me këtë përbërje: 2 (dy) përfaqësues nga Fakulteti i Drejtësisë dhe 3 (tre) të tjerët nga njësitë e tjera kryesore. Fitues shpallen kandidatët me numrin më të madh të votave sipas kësaj ndarjeje.
2. Për formimin e tij, Senati Akademik i UT-së, pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelimit të institucionit, në një ditë me atë të KIZ-it. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që:
 - a) kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet me kohë të plotë;
 - b) nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Komisioni i zgjedhur i Apelimit, në mbledhjen e parë zgjedh kryetarin dhe sekretarin e tij, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve.
4. Anëtarët e Komisionit të Apelimit kanë një mandat 4-vjeçar.



5. Në rastin e largimit të një anëtarit nga ky komision, zëvendësimi i tij kryhet sipas pikës 1 të këtij neni.
6. Rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelit hartohen dhe vendosen prej këtij komisioni, menjëherë pas konstituimit të tij dhe zgjedhjes së kryetarit e sekretarit.
7. Anëtarët e Komisionit të Apelit shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të UT-së.
8. Komisioni i Apelit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet “kundër”, për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ-it.
9. Vendimi i Komisionit të Apelit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyrueshëm për t’u zbatuar.
10. Kundër vendimeve të Komisionit të Apelit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.

Neni 38
Pavlefshmëria e zgjedhjeve

1. KIZ-i, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë njësi kryesore, në rast se:
 - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit dhe të kësaj rregulloreje që e kanë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
 - b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të atilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;
 - c) votimi nuk ka filluar ose është pezulluar për më shumë se 5 (pesë) orë.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për shkaqet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar.
3. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën, bëhet nga KIZ-i, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendrike nga depozitimi i saj.
4. Vendimi i KIZ-it është i ankimeshëm në Komisionin e Apelit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
5. Pas vendimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve, shpallen zgjedhje të reja, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 dhe kësaj rregulloreje.



Neni 39
Dispozita të fundit

1. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimeve në Komisionin e Apelit, KIZ-i shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të UT-së, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. KIZ-i i përcjell ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit, vendimin për shpalljen e fituesit rektor të UT-së. Ministri i Arsimit dhe Sporteve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor, i përcjell Presidentit të Republikës vendimin e KIZ-it për shpalljen e fituesit rektor të UT-së.
3. Mbledhja e parë e Senatit Akademik të UT-së mbahet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dekretimi i rektorit prej Presidentit të Republikës.
4. Rektori i zgjedhur dhe i dekretuar, konfirmon drejtuesit e zgjedhur të njësive kryesore të UT-së, brenda 7 ditëve nga dekretimi i tij.
5. Dekani/drejtori i zgjedhur i njësisë kryesore konfirmon drejtuesit e zgjedhur të njësive bazë/qendrave të kërkimit shkencor, brenda 7 (shtatë) ditëve të emërimit të tij.
6. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivin e institucionit, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
7. Monitorimi i procesit zgjedhor në të gjitha komisionet zgjedhore ose qendrat e votimit, realizohet nga kandidatët dhe vëzhguesit e akredituar.
8. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha njësitë kryesore dhe filialet e UT-së.
9. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UT-së.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. MYNYR KONI

